



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3168.prot.

Gramsh, më 29.01/2024

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8/2, neni 9/1.1 pika “b”; neni 59/2, neni 64/g; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Bashkia Gramsh, njofton shpalljen për:

2 (dy) vende të lira pune në pozicionin: Shofer/Manovrator, në Sektorin e Infrastrukturës Rrugore;

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si mësipër është:

KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E VECANTA SI VIJON:

- Të zotërojnë diplomë të shkollës së Mesme;
- Të zotërojnë patentë specifike për mjete të rënda dhe Dëshmi Aftësie Profesionale për Eskavatorist.
- Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit, në Institucione publike dhe private, në profesion.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Jetëshkrim i plotësuar ;
3. Fotokopje të diplomës së gjimnazit;
4. Fotokopje të patenatve dhe dëshmime të kualifikimit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Certifikatë familjare;
8. Certifikatë personale;
9. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
10. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti);
11. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria;
12. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajtimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 30.07.2024

KRYETARI

BESION AJAZI

